

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.M. , nga fshati ..., komuna e Skenderajt, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, e të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj P.nr.367/18, datë 20.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.02.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, P.nr.367/18, datë 20.12.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Skënderaj, me aktgjykimin P.nr.367/2018, datë 20.12.2018, të akuzuarin H.M., e ka shpallë fajtor për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 275 par.1 të KPRK-së e ka shpallë fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me burgim me kohëzgjatje prej 1(një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 2(dy) vitesh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nuk do të kryej vepër penale dhe dënim me gjobë në lartësi prej 300(treqind) € të cilat është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë. Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nga gjykata nuk e paguan dënimin me gjobë, atëherë ky dënim do të zëvendësohet në dënim me burgim sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së. Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 20 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 10 €, gjithashtu në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjyqimit. Është urdhëruar konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike e llojit Kanabis - marihuana e që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), në sasi prej 4.51 gram. Substanca e lartcekur pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohet nga Policia e Kosovës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka ushtruar:

-Prokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj , dhe atë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj

ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lartë me burgim efektiv.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.148/2019, datë 13.02.2019 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të shtetit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, P.nr.367/18, të datës 20.12.2018, ashtu që i njëjti të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk animohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Prokurori i shtetit, sa i përket vendimit mbi dënimin në ankesë pretendon se, përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë këtë çështje penale e ka gjykuar drejtë dhe mbi bazën e fakteve të argumentuara, në seancë ka vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale. Mirëpo, prokurori i shtetit konsideron se gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit nuk i ka shqiptuar dënim të merituar në krahasim me peshën e veprës së kryer. Gjegjësisht bëhet fjalë për veprën penale nga grupi i veprave penale lidhur me substanca narkotike , ku rreziku shoqëror matet me shëndetin e njerëzve , kurse shëndeti i njerëzve është vlera më e madhe e njerëzimit. Neni 275, par.1 i KPRK-së në mënyrë kualifikuese i referohet kryesve të këtyre veprave penale të cilët posedojnë substanca narkotike, psikotrope ose të ngjashme ne sasi nën 3gr.- konkretisht ose hashash, sasi kjo e cila supozohet të jet e destinuar për përdorim personal. Në rastin konkret i akuzuari H.M. ka poseduar substanca narkotike kanabis- marihuanës në sasi prej 4.51 gr. Me rastin e shqiptimit të sanksionit penal gjyqtari i ka marrë parasysh kryesisht rrethanat lehtësuese , por jo në propocion me ato rënduese, sipas rregullave të përgjithshme nga neni 73 të KPRK-së. Me këtë lloj dhe lartësi të dënimin nuk është arritur qëllimi, përkatësisht objektivi i përgjithshëm i

ndëshkimit në kuptimin e parandalimit të veçantë dhe të përgjithshëm. Kryesi ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer penale dhe e kupton rëndësinë e kësaj veprë, andaj me një ndëshki9m më të rreptë ai në të ardhmen do të kishte pasur një raport me ndryshe ndaj aktit të paligjshëm, e kjo kishte ndikuar edhe me kryesit e tjerë potencial të veprave penale. Me ndëshkim më të rreptë do të përmbushej qëllimi dhe objektivi i parandalimit të veçantë e pastaj edhe ai gjeneral.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit të shtetit që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim me i ashpër me nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, në rastin konkret gjykata për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë, ishte korrekt para gjykatës së shkallës së parë po i njëjti është i papunë , i gjendjes së dobët ekonomike, shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuara ndërsa si rrethanë rënduese gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë. Rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e prokurorit të shtetit, nuk janë të bazuara, nuk qëndrojnë, ngase të njëjtat sipas vlerësimit të kësaj gjykate kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë ,prandaj duke marrë për bazë mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e me qenë se në ankesë nuk ceket ndonjë rrethanë veçanërisht e re rënduese apo lehtësuese, të cilat do të kishin pasur ndikim në shqiptimin e një dënimi më të ashpër apo më të butë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale te të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.127/19, datë 25.02.2019

Zyrtari ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Biljana Rexhiq

